



# Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

## Raport vjetor

Janar - Dhjetor  
2024

## **RAPORT I PUNËS DHE I PËMBUSHJES SË DETYRAVE PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2024.**

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës gjatë periudhës janar-shtator 2024 ka zhvilluar një seri aktivitete të cilat mund të klasifikohen në aktivitete të rëndomta të funksionimit të IAL-së si dhe në aktivitete tjera të cilat kanë për qëllim përmbushjen e strategjisë së Universitetit të Prishtinës, përkatësisht të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit sikur janë organizimi i konferencës ndërkombëtare studentore, bashkëpunimet me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizimi i ligjëratave të hapura, dhe të tjera.

Misioni i FIN-it është i bazuar në misionin e Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e veprimeve akademike, hulumtimeve, punës shkencore dhe të krijojë kuadro profesionale të arsimit të lartë për tregun e punës për fushat e inxhinierisë së ndërtimit në pajtim me interesat strategjike dhe zhvillimore të vendit.

Për më saktësisht, Misioni i FIN-it është të krijojë, të zhvillojë, të mbrojë dhe të transmetojë njohuri përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore dhe po ashtu të ofrojë mundësi për të gjithë banorët e Kosovës për të përfituar nga ky arsim tërë jetësor pa kufizime.

Në këtë mënyrë, niveli universitar i studimeve në njësi akademike arrin të parapërgatitë studentë për t'u përshtatur mirë dhe shpejt në pozicione bazë në tregun e punës. Njëkohësisht, niveli universitar krijon premisa të mira për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta, përmes njohurive lehtësisht transferuese në disiplina të përafërta.

Veprimtaria e njësisë sonë akademike, karakterizohet me bashkëveprimin në mes të veprimtarisë mësimdhënëse dhe asaj kërkimore-shkencore.

Aktivitetet kryesore të IAL-së fokusohen në:

- mësimdhënie - mësimnxënie,
- kërkime të vazhdueshme shkencore në shërbim të shoqërisë dhe vendit,
- zhvillim të kuadrove profesionalisht që janë kompatible me kërkesat e tregut,
- zhvillim të aktiviteteve në fusha të nevojshme për kërkesat e tregut,
- ofrime të shërbimeve dhe ekspertizave për palët e treta,
- hulumtime në zhvillimin e patentëve nga ana e personelit akademik.

Qëllimi i FIN-it është që të ketë rol udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë dhe gjithashtu të krijojë dhe të mbështes standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. FIN-i kërkon t'u përshtatet Standardeve Evropiane dhe të integrohet plotësisht në zonën Evropiane të arsimit të lartë sipas Deklaratës së Bolonjës.

Mësimdhënia dhe kërkimet shkencore, paraqesin veprimtarinë kryesore të kësaj njësie akademike. Veprimtarinë e një njësie akademike e karakterizon bashkëveprimi ndërmjet veprimtarisë mësimdhënëse dhe asaj kërkimore-shkencore. Kjo, për faktin se, për arritjen e rezultateve të dëshiruara në studime, mësimdhënia duhet të jetë e pa ndarë nga puna kërkimore shkencore.

Plani strategjik i zhvillimit të FIN-it për periudhën 2021-2023 si dhe Plani Strategjik i FIN-it 2024-2028 të miratuar nga Këshilli i Fakultetit dhe i publikuar në faqen elektronike <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,85> përcaktojnë qëllimet e arritjeve institucionale për periudhën e janar-shtator 2024, me prioritet:

- Rritjen e vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Përmirësimin dhe shtimin e rritjes së kapaciteteve të stafit akademik dhe ambienteve të mësimin.
- Rritjen e cilësisë për shërbimet e studentëve.
- Promovimin dhe rritjen e standardeve të cilësisë për programet e studimeve.
- Ngritjen e kapaciteteve të Laboratorëve për fushat profesionale shkencore.
- Avancimin e kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore në nivele ndërkombëtare.

Vizioni i **FIN**-it është:


FIN të jetë një qendër e shquar e arsimit të inxhinierisë së ndërtimit në Kosovë duke u njohur ndërkombëtarisht për programet e studimeve, cilësinë e arsimit dhe kontributin Institucional në zhvillimin e qëndrueshëm të fushës së inxhinierisë së ndërtimit.

- Shkalla e fleksibilitetit dhe shpejtësia e përshtatshmërisë së programeve të studimeve sipas nevojave dhe kërkesave të tregut të punës duke siguruar cilësi të lartë në të gjitha aktivitetet akademike, hulumtime, mësimdhënie si dhe shërbimeve tjera të kërkuara nga institucionet vendore.
- Punë kërkimore dhe akademike të mësimdhënësve dhe studentëve për të mbështetur procesin e mësimdhënies cilësore, vlerësimeve bashkëkohore, mësimnxënies, si procese të vazhdueshme Institucionale.
- Krijimi i kushteve dhe mundësive të pa penguara për zhvillimin dhe avancimin e aktiviteteve akademike për mësimdhënie të avancuar dhe hulumtime shkencore të stafit akademik.
- Angazhim aktiv i studentëve si në aspektin individual ashtu edhe kolektiv në jetën e aktiviteteve të Fakultetit, përkatësisht zhvillimit të programeve të studimeve dhe në mësimnxënien e tyre.
- Zhvillimi dhe avancimi i programeve të studimeve të fushave të Inxhinierisë së Ndërtimit, përkatësisht të Konstruksioneve, Gjeodezisë, Hidroteknikës, Inxhinierisë së Ambientit dhe Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore, duke u mbështetur në arritjet shkencore dhe arsimore në Evropë dhe botë.
- Fokusimi evropian dhe ndërkombëtar në fushat e Inxhinierisë së ndërtimit, përkatësisht Konstruksioneve, Gjeodezisë, Hidroteknikës, Inxhinierisë së Ambientit dhe Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore, që t'i sigurojmë studentit dhe stafit akademik lëvizshmëri dhe krahasueshmëri të standardeve në kualifikimet dhe diplomat e arritura. Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar të integrohem plotësisht në zonën evropiane të arsimit të lartë.

Në këtë mënyrë niveli universitar i studimeve në njësi akademike arrin të parapërgatitë studentë për t'u përshtatur mirë dhe shpejt në pozicione bazë në tregun e punës. Njëkohësisht, niveli universitar krijon premisa të mira për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta, përmes njohurive lehtësisht transferuese në disiplina të përafërta.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit funksionon në mënyrë të organizuar sipas organogramës së treguar më poshtë.

# FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT




Organograme e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

Faqja elektronike e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit <https://fin.uni-pr.edu/> përditësohet dhe freskohet me informata aktuale në baza të rregullta kohore. Freskimi i publikimeve, informatave për gjithë spektrin e pedagogëve, studentëve, administratës dhe Bordin Industrial bëhet në kohë reale.

Në çdo vit akademik Fakulteti zgjedh dhe nominon studentët e dalluar për të cilët ndanë mirënjohje dhe se këta studentë publikohen në faqen elektronike të Fakultetit ndërsa në aktivitete të veçanta të njëjtët student janë me prioritet të zgjedhjes. <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,158>. Për vitin akademik 2024/2025 janë zgjedhur studentët e dalluar të me notën mesatare mbi 9.

Fondacioni “Nexhmedin Kusari - Daka” shpërndau 15 bursa për studentët e shkëlqyer të FIN për vitin akademik 2024/2025. Fondacioni “Nexhmedin Kusari - Daka” edhe në të kaluarën ka shpërndarë bursa duke i mbështet studentët tonë.

Mirënjohjet për studentet e dalluar: Dea Metaj, Yllka Thaqi, Rigon Meleqi, Leart Shehu, Adea Shala, Leonit Totaj, Vesa Ademaj, Fjolla Trepça, Armend Totaj, Egzon Kokollari, Fatime Guri, Mirela Balaj, Valmir Lokaj, Elsa Alaj, Idriz Koraqi, Ilirjan Haskaj, Lirim Qazimi, Burim Seferi, Erti Jakupi, Anita Hajredini, Argjenda Berisha, Rreze Konjusha dhe Eda Krasniqi. Krahasuar me katër vitet e fundit, vërehet qëndrueshmëri në rritje të cilësisë së arritjeve të studentëve.



*Figura 2. Diagrami i Studentëve të shkëlqyer në tre vitet e fundit.*

Gjatë muajit janar 2024, stafi dhe administrata e FIN-it është angazhuar për fushatë të sensibilizimit të maturantëve të shkollave të mesme në Kosovë. Janë organizuar takime për përgatitjen e materialeve njoftuese përkatësisht fletëpalosje me informata përmbajtjesore nga FIN-i dhe programet e studimeve të cilat organizohen nga IAL. Kalendari i organizimit të ditëve të hapura është më produktiv kur organizohet në nivel të Universitetit.

Për mbarëvajtjen e mësimit në programet e studimeve dhe sipas kërkesës së departamenteve dhe miratimit të këshillit të FIN-it, në pajtim me rregulloret dhe vendimin e senatit angazhohen Profesorët Vizitor për vitin akademik 2024/2025 nga Universiteti Politeknik i Tiranës, përkatësisht Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti i Kolnit, dhe Universiteti i Maqedonisë së Veriut, sipas kësaj radhitje:

1. Prof.Dr. Neritan Shkodrani, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.

2. Prof.Dr. Oltion Marku, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.
3. Prof.Dr. Lars Ribbe, Faculty of Spatial Development and Infrastructure Systems Institute for Technology and Resources Management in the Tropics and Subtropics (ITT), Technology Arts Sciences TH Koln, Gjermani.
4. Dr.Sc. Sudeh Denhavi, Faculty of Spatial Development and Infrastructure Systems Institute for Technology and Resources Management in the Tropics and Subtropics (ITT), Technology Arts Sciences TH Koln, Gjermani.
5. Juan Luis Ramirez, Faculty of Spatial Development and Infrastructure Systems Institute for Technology and Resources Management in the Tropics and Subtropics (ITT), Technology Arts Sciences TH Koln, Gjermani.
6. Rosa Allabashi, Institute of Sanitary Engineering and Water Pollution Control, Boku University, Vien, Austri.
7. Xhesika Hoxha, Faculty of Spatial Development and Infrastructure Systems Institute for Technology and Resources Management in the Tropics and Subtropics (ITT), Technology Arts Sciences TH Koln, Gjermani.
8. Prof. Vlado Spiridonov, Universiteti “Kirily and Methody” Shkup, Maqedonia e Veriut.
9. Prof.Dr. Biljana Puleska, Universiteti “Kirily and Methody” Shkup, Maqedonia e Veriut.
10. Prof.Dr. Cvetanka Popovska, Universiteti “Kirily and Methody” Shkup, Maqedonia e Veriut.

Profesorët vizitor sipas radhitjes, ju përgatiten kontratat sipas propozimit:

1. Prof.Dr. Neritan Shkodrani, kontrata për ngarkesë të plotë, edhe pse ngarkesa për semestrin dimëror është 9 orë ndërsa për semestrin veror është 12 orë, Fakulteti riorganizon ngarkesën në variantin që lëndët e drejtimeve të ndryshme mund të bëhen në një lëndë të vetme.
2. Prof.Dr. Oltion Marku, kontrata për ngarkesë në semestrin dimëror 6 orë ndërsa për semestrin veror është 4 orë.

Për mësimdhënësit – Profesor Vizitor (pozitat 3 deri 10) ju bëhen kontratat sipas ngarkesës në tabela, mirëpo për angazhimin e tyre, Universiteti i Prishtinës nuk ka detyrime financiare pasi që kompensimi i tyre financiar bëhet nga mbështetësi i organizimit të programit të studimeve Master MIRU realizohet nga SKAT-i.

## 1.1. MËSIMDHËNJA AKADEMIKE

### 1.1.1 Numri i Studentëve në FIN

Numri i studentëve aktiv në Fakultet të Inxhinierisë së Ndërtimit për të gjitha programet e studimeve të niveleve BSc dhe MSc janë 960, prej të cilëve 635 meshkuj dhe 325 femra.

Programet e studimeve Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi, Inxhinieri e Ambientit, Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore përbëhen nga kurrikulat të formuara nga lëndë të përgjithshme, lëndët me karakter formues profesional, lëndët integruese, profesionale, plotësuese dhe temës së diplomës (Baçelor dhe/ose Master) e cila është e bazuar në aplikimin e njohurive paraprake dhe në hulumtime paraprake.

Tabela 1 Numri i studentëve aktual në Programet e Studimeve në nivel të FIN 2024/2025

	Bachelor			Master			Total		
	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M
Konstruksione	461	137	324	108	30	79	569	167	403
Hidroteknikë	58	11	47	49	28	21	107	39	68
Gjeodezi	141	39	102	43	14	29	184	53	131
Inxhinieri e Ambientit	64	45	19				64	45	19
MIRU - IWRM				36	22	13	36	22	36
<b>TOTAL</b>	<b>724</b>	<b>232</b>	<b>492</b>	<b>236</b>	<b>94</b>	<b>142</b>	<b>960</b>	<b>326</b>	<b>634</b>




Figura 2: Numri aktual i Studentëve në FIN për periudhën deri në dhjetor 2024

Numri i studentëve të ri për të studiuar në programet e studimeve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit është në rënje krahasuar me vitet paraprake, mirëpo duke falënderuar fushatat sensibilizuese të stafit të FIN në vitin 2024 ka një ruajtje të numrit të studentëve të rexhistruar me një rritje jo të madhe. Pranimi i studentëve të ri për vitin akademik 2024/2025 në të gjitha programet e studimeve në nivelin Bsc janë 163 student dhe programet e studimeve MSc janë 55 student. Kapaciteti i programeve të studimeve për studentë të ri në të gjitha programet e studimeve është 320 student, ndërsa të regjistruar për vitin akademik 2024/2025 janë gjithsej 218, ndërsa student të regjistruar në vitin e parë të studimeve Baçelor në fin për vitin

akademik 2024/2025 janë 291, nga të cilët 39.86 % janë të gjinisë Femra dhe 60.14% Meshkuj.

Tabela 2. Numri i studentëve të regjistruar për herën e parë në nivelin e studimeve Bachelor në FIN për 2024/2025

Nr.	Departamenti-Programi	Numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt FIN							
		Gjinia	I	II	III	IV	V	VI	Gjithsej
1	Programi Konstruktiv	F	31	15	10	0	0	0	56
		M	39	34	31	0	0	0	104
		GJ	70	49	41	0	0	0	160
2	Programi Gjeodezi	F	15	2	8	0	0	0	25
		M	31	8	6	0	0	0	45
		GJ	46	10	14	0	0	0	70
3	Programi Inxhinieri e Ambientit	F	21	6	4	0	0	0	31
		M	7	0	2	0	0	0	9
		GJ	28	6	6	0	0	0	40
4	Programi Hidroteknikë	F	3	0	1	0	0	0	4
		M	7	5	5	0	0	0	17
		GJ	10	5	6	0	0	0	21
<b>GJITHSEJ</b>		F	70	23	23	0	0	0	116
		M	84	47	44	0	0	0	175
		GJ	154	70	67	0	0	0	291




Figura 3. Numri i studentëve të FIN-së të pranuar në tetë vitet e kaluara për studime në programet e studimeve BSc.




Figura 4. Numri i studentëve të FIN-së të pranuar në pesë vitet e kaluara për studime në programet e studimeve MSc.

Janë disa raste të mobilitete të studentëve nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në institucionet Evropiane, sikur: Universiteti i Trentos, Itali; Universiteti Teknik i Vjenës –



studime doktoratës, Austri; “Poznan University of Life Sciences” Poloni; Universiteti Teknik i Çekisë në Pragë, Universiteti Minjo në Portugali.

Studentëve të Fakultetit ju është dhënë hapësirë në faqen elektronike të Fakultetit. <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,4> Janë evidencat e Studentëve transparente të përfaqësimeve të studentëve nga Këshilli i Studentëve, përfaqësues të studentëve në Këshillin e Fakultetit, Studentët e dalluar, Puna e studentëve, Punimet e diplomave Master të Studentëve, etj.

### 1.1.1.2 Student të Diplomuar

Numri i të diplomuarve sipas statistikave të SEMS-it për Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit sipas departamenteve, përkatësisht programeve të studimeve për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor të vitit 2024 janë:

Tabela 3: numri i studentëve të diplomuar në nivelin Baçelor të studimeve për vitin 2024

nr	Programi i studimeve – Baçelor	Numri i te diplomarëve
1	Konstruktiv	32
2	Hidroteknikë	4
3	Gjeodezi	11
4	Inxhinieri e Ambientit	10
	<b>Total</b>	<b>57</b>




Figura 5: studentët e diplomuar në BSc dhe MSc FIN për vitin 2024.

Tabela 4: numri i studentëve të diplomuar në nivelin Master të studimeve për vitin 2024

nr	Programi i studimeve – Master	Numri i te diplomarëve
1	Konstruktiv	22
2	Hidroteknikë	5
3	Gjeodezi	2
4	MIRU	0
	<b>Total</b>	<b>29</b>

Procedurat e organizimit të diplomave në nivelet BSc dhe MSc janë në përputhje sipas rregulloreve përkatëse të studimeve.

Sipas programeve të studimeve dhe viteve të kaluara, në tabelën vijuese janë treguar numri i studentëve të diplomuar në periudhën 6 vjeçare (01 janar 2019 deri 31 dhjetor 2024).

Tabela 5: Numri i Studentëve të diplomuar në BSc nga viti në vit, nga 2019 deri 2024

Programi I Studimit	2024 – janar dhjetor			2023 – janar dhjetor			2022 – janar dhjetor			2021 – janar dhjetor			2020 - janar dhjetor			2019 – janar dhjetor			Gjithsej		
	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ
Konstruktiv	15	40	55	7	36	43	10	36	46	14	54	68	12	47	59	14	58	72	72	271	343
Gjeodezi	8	5	13	5	16	21	5	32	37	7	27	34	10	24	34	20	43	63	55	147	202
Hidroteknikë	4	4	8	1	17	18	11	17	28	7	17	24	5	9	14	13	19	32	41	83	124
Inxhinieri e Ambientit	7	3	10	12	3	15	15	5	20	15	5	20	10	1	11	6	1	7	65	18	83
<b>GJITHSEJ</b>	<b>34</b>	<b>52</b>	<b>86</b>	<b>25</b>	<b>72</b>	<b>97</b>	<b>41</b>	<b>90</b>	<b>131</b>	<b>43</b>	<b>103</b>	<b>146</b>	<b>37</b>	<b>81</b>	<b>118</b>	<b>53</b>	<b>121</b>	<b>174</b>	<b>233</b>	<b>519</b>	<b>752</b>

Numri i studentëve të diplomuar në BSc për periudhën e kaluar 6 vjeçare




Figura 6. Numri i Studentëve të diplomuar në BSc në vitet 2019 deri 2024

Ndërsa në programet e studimeve Master, në 6 vitet e fundit numri i Studentëve të diplomuar janë sikur në tabelën në vazhdim.

Tabela 6: Numri i Studentëve të diplomuar në MSc nga viti në vit, nga 2019 deri 2024

Programi I Studimit	2024 – janar dhjetor			2023 – janar dhjetor			2022 – janar dhjetor			2021 – janar dhjetor			2020 - janar dhjetor			2019 – janar dhjetor			Gjithsej		
	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ
Konstruktiv	7	15	22	4	9	13	7	12	19	2	12	14	1	18	19	4	9	13	25	75	100
Hidroteknikë	2	3	5	3	9	12	2	9	11	5	3	8	4	3	7	1	2	3	15	26	41
Gjeodezi	1	1	2	1	1	2	0	1	1	1	4	5	1	1	2	0	1	1	1	8	9
Infrastruktura rrugore	0	0	0	2	0	2	0	1	1	0	0	0	0	3	3	0	1	1	2	5	7
<b>GJITHSEJ</b>	<b>10</b>	<b>19</b>	<b>29</b>	<b>10</b>	<b>18</b>	<b>29</b>	<b>9</b>	<b>23</b>	<b>32</b>	<b>8</b>	<b>19</b>	<b>27</b>	<b>6</b>	<b>25</b>	<b>31</b>	<b>5</b>	<b>13</b>	<b>18</b>	<b>43</b>	<b>114</b>	<b>157</b>




Figura 7. Numri i Studentëve të diplomuar në MSc në vitet 2019 deri 2024

Numri i studentëve të cilët kanë braktisur studimet nga programet e studimeve në FIN për vitin 2024 në bazë të evidencës janë 27.

Tabela 7: Numri i Studentëve të çregjistruar, nga 2022 deri 2024

	Bachelor			Master		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Programi Gjeodezi	3	3	3	0	0	0
Programi Hidroteknikë	7	2	3	0	1	2
Programi Inxhinieri e Ambientit	1	2	5	0	0	0
Programi Konstruktiv	4	9	16	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>27</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>2</b>

### 1.1.5. Provimet dhe Punimet Seminarike

Provime të rregullta për Studentët e FIN organizohen sipas Statutit të UP-së në afatet e janarit (15 janar deri 15 shkurt), qershorit (05 qershor deri 15 Korrik ) dhe shtatorit (22 gusht deri 15 shtator). Njoftimi i studentëve për paraqitjen e provimeve të afateve të rregullta ndodhë para fillimit të provimeve (për afatin e janarit – SEMS-i është hapur për paraqitje prej datës 08 deri 22 janar, për afatin e qershorit nga data 04 deri 07 qershor dhe për afatin e shtatorit nga data 05 deri 22 gusht). Platforma SEMS për notime mbyllet sipas njoftimeve paraprake në platformën elektronike të FIN (për afatin e janarit – 28 shkurt, për afatin e qershorit 25 korrik dhe për afatin e shtatorit 20 shtator).

Në nëntor 2024 është organizuar vlerësimi i vazhdueshëm për studentët e vitit paraprak në datat 29 nëntor dhe 06 dhjetor me mundësi të paraqitjeve të studentëve në tri lëndë sipas vendimit të Senatit të UP-së nr. 4/431 të datës 11 nëntor 2024.

Pas vendimit të senatit, menaxhmenti i FIN ka sensibilizuar të gjithë stafin, shefat e departamenteve në takimet kolegjiale të Departamenteve, dhe në Këshilli të Fakultetit për përmbushjen e detyruar të obligimeve akademike. Shefat e departamenteve kanë hartuar raporte të ndara lidhur me aktivitetet përmbushura nga Vendimi i Senatit. Sipas vendimit të senatit, raporteve të shefave të departamenteve, monitorimit të vazhdueshëm të menaxhmentit të FIN, për semestrin dimëror të vitit akademik 2024/2025, për periudhën kohore nga 16 shtatori deri 29 nëntor 2024,.

1. I gjithë stafi akademik, bartësit e lëndëve nga programet e studimeve të të dy niveleve i ngarkuan syllabuset dhe ligjëratat e tyre në platformën e SEMS.
2. Janë publikuar të gjitha afatet e vlerësimeve të vazhdueshme të studentëve për lëndët dhe për lëndët e vitit dhe semestrin paraprak para afatit të janarit të vitit 2025. Sipas paralajmërimeve të gjitha vlerësimet duhet të mbyllet para datës 20 dhjetor 2024. Në faqen elektronike të fakultetit janë bërë publike datat e organizimeve të vlerësimit të studentëve [29 nëntor dhe 6 dhjetor 2024], <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,2>. Gjithashtu janë publikuar afatet kohore të vlerësimeve të vazhdueshme për muajin prill të viti 2025.
3. Sipas Vendimit të Senatit, FIN ka shpallur njoftimin se numri i lëndëve të vitit paraprak të studimeve për studentët të jetë maksimum tri lëndë.
4. Sipas agjendës me shefat e Departamenteve, janë njoftuar të gjithë stafi i FIN se deri me datë 26 nëntor duhet të konfigurujnë të gjitha lëndët për vlerësim të vazhdueshëm.
5. FIN dhe menaxhmenti ka publikuar kalendarin për afatet e rregullta të provimeve të janarit, qershorit dhe shtatorit për studentët, <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,2,1>. Orari i provimeve të afateve të rregullta të provimeve është i qëndrueshëm dhe i pa ndryshuar - standardizuar për të gjitha vitet.
6. FIN respekton agjendën sipas vendimit të senatit lidhur me raportimet mbi vlerësimin e vazhdueshëm.

Në bazë të aktiviteteve që FIN dhe menaxhmenti i konsideron meritore, janë zhvillime të rregullta akademike të cilat në vazhdimësi monitorohen përmes raporteve të mësimdhënësve, raportimeve të departamenteve si dhe informatave të sintetizuara edhe në këshillin e Fakultetit.

Sipas vendimit të senatit, menaxhmenti i FIN ka sensibilizuar të gjithë stafin, shefat e departamenteve në takimet kolegjiale të Departamenteve, dhe në Këshilli të Fakultetit për përmbushjen e detyruar të obligimeve akademike. Shefat e departamenteve kanë hartuar raporte të ndara lidhur me aktivitetet përmbushura nga Vendimi i Senatit. Sipas vendimit të senatit, raporteve të shefave të departamenteve, monitorimit të vazhdueshëm të menaxhmentit të FIN, për semestrin dimëror të vitit akademik 2024/2025, për semestrin dimëror të vitit akademik 2024/2025.

Nga Departamenti Konstruktiv, raporti përmban:



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
UNIVERSITY OF PRISTINA  
FAKULTETI I INZHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY  
Rr. Agim Ramadani, Njërtesa e "Fakulteteve Teknike", 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 554 899 URL: <https://fin.uni-pr.edu> e-mail: [fin@uni-pr.edu](mailto:fin@uni-pr.edu)

#### RAPORTI I VLERESIMIT TË VAZHDESHEM

Fakulteti i Inzhinierisë së Ndërtimit – Departamenti Konstruksione

Në bazë të vendimit të Senatit për Vlerësimin e Vazhdueshëm të studentëve, Fakulteti i Inzhinierisë së Ndërtimit – Departamenti i Konstruksioneve ka nisur implementimin e këtij procesi. Shumica e stafit akademik ka përfunduar konfigurimin përkatës të "Modulit për Vlerësimin e Studentëve" në SEMS, kanë ngarkuar syllabuset dhe materialet mësimore (literaturën dhe materialet përcjellëse) dhe kanë dorëzuar raportet për vlerësimin e vazhdueshëm të Shefi i Departamentit, në përputhje me Nenin 114 të Statutit të Universitetit të Prishtinës. Më poshtë është lista e stafit akademik që e kanë zbatuar dhe atyre që ende nuk e kanë zbatuar procesin e vlerësimit të vazhdueshëm deri më tani:

1. Prof. Dr. Naser Kabashi - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  2. Prof. Asoc. Arton Dautaj - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  3. Prof. Asoc. Cene Krasniqi - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  4. Prof. Asoc. Fatos Ellana - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  5. Prof. Asst. Esat Gashi - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  6. Prof. Asst. Fidan Salihu - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  7. Prof. Asst. Florim Graicevci - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  8. Prof. Asst. Hajdar Sadiku - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  9. Prof. Asst. Milot Mubaxheri - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  10. Prof. Asst. Zijadin Guri - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
- Profesorët e Angazhuar*
11. Prof. Dr. Abdullah Zejnullahu – Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  12. Prof. Asoc. Misin Misini - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  13. Prof. Asst. Ragim Hadri - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  14. Prof. Neritan Shkodrani - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  15. Ilir Rodiqi – Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  16. Ardita Ibishi - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  17. Prof. Dr. Arta Basha – Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm
  18. Prof. Asst. Gazmend Nafezi - Ka bërë Vlerësim të Vazhdueshëm

*Nga tetëmbëdhjetë profesorë të stafit akademik – departamenti Konstruksione –të gjithë kanë bërë Vlerësim të Vazhdueshëm./*

Shefi i Departamentit  
Prof. Asst. Dr. Zijadin GURI

Prishtinë 10.1.2025

## Nga Departamenti i Hidroteknikës, raporti përmban:

### RAPORTI PËR VLERËSIMIN E VAZHDUESHËM TË STUDENTËVE – SEMESTRI DIMËROR 2024/2025

Shefi i Departamentit të Hidroteknikës  
Data: 08/01/2025

Bazuar në vendimin e senatit Mbi procedurat për vlerësimin e studenteve dhe mbajtjen e provimeve, me nr. Prot 4/431 dhe date 11/11/2024 raportohet si vijon për vlerësimin e vazhdueshëm të studentëve për programet studimore BSc Hidroteknike, MSc Hidroteknike dhe MSc IWRM për semestrin dimëror 2024/2025.

Te gjithë profesorët e angazhuar në programet BSc Hidroteknike, MSc Hidroteknike dhe MSc IWRM janë zotuar se do të publikojnë syllabusin dhe literaturën e lëndëve në SEMS dhe do të bëjnë vlerësimin e vazhdueshëm të studentëve.

Megjithatë vtem disa nga ta kanë ofruar dëshmi në lidhje me vlerësimin e vazhdueshëm dhe ate si në vijim:

#### 1. Programi Studimor BSc Hidroteknike

Nga 17 lëndet e semestrave dimëror të këtij programi, 6 profesore kanë ofruar dëshmi për vlerësimin e vazhdueshëm për lëndë dhe ate : Konstruksionet e betonit, Mekanikë e fluideve, Inxhinieri e lumenjeve dhe Shfrytëzimi i fuqisë së ujërave.

- Numri i përgjithshëm i lëndëve dimërore: 17
- Numri i lëndëve me dëshmi për vlerësimin e vazhdueshëm: 8
- Përqindja e lëndëve me dëshmi: 47%
- Profesorët që kanë dorëzuar dëshmi:
  - Hajdar Sadiku
  - Florim Grajcevc
  - Abdullah Zejnullahu
  - Fidan Salihu
  - Laura Kusari
  - Arban Berisha
  - Ardita Ibishi.
- Lëndët për të cilat është dorëzuar dëshmi:

#### 3. Programi Studimor MSc IWRM

Nga 12 lëndet e semestrave dimëror në Programin studimor MSc IWRM, 8 profesore kanë dërguar dëshmi mbi vlerësimin e vazhdueshëm dhe ate Naser Kabashi, Lavdim Osmanaj, Laura Kusari, Mjellma Carrabregu, Ferdije Zhushi, Halil Ibrahim, Milot Muhaxheri dhe Linda Gusia, për 10 lëndet : Methodology of research and study design, Hydrology and Hydrometry, Hydraulic Structures, Intro IWRM and Water security, Water and conflict, Water economics, Biophysical characterization of water, Hydraulic Modeling, Meteorology dhe Ecosystem based management.

- Numri i përgjithshëm i lëndëve dimërore: 12
- Numri i lëndëve me dëshmi për vlerësimin e vazhdueshëm: 10
- Përqindja e lëndëve me dëshmi: 83%
- Profesorët që kanë dorëzuar dëshmi:
  - Naser Kabashi
  - Laura Kusari
  - Linda Gusia
  - Mjellma Carrabregu
  - Halil Ibrahim
  - Ferdije Zhushi
  - Milot Muhaxheri
  - Lavdim Osmanaj
- Lëndët për të cilat është dorëzuar dëshmi:
  - Methodology of Research and Study Design
  - Hydrology and Hydrometry
  - Hydraulic Structures
  - Intro to IWRM and Water Security
  - Water and Conflict
  - Biophysical characterization of water,
  - Hydraulic Modeling,
  - Meteorology

- Mekanikë e fluideve
- Konstruksionet prej betonit
- Inxhinieria e lumenjeve
- Shfrytëzimi i fuqisë së ujërave I
- Hyrje në Inxhineierinë e ndertimit
- Matematika I
- Punet tokësore dhe mekanizimi
- Gjuhe angleze

Profesorët Milot Muhaxheri dhe Ismail Kabashi kanë raportuar të mos kenë bërë vlerësim të vazhdueshëm të studentëve.

#### 2. Programi Studimor MSc Hidroteknike

Duke qenë se mesimi në Programin studimor MSc Hidroteknike është duke u mbajtur vetëm në smestrin e tretë, nga 6 lëndet mesimore të këtij semestri, vetëm për lëndë mesimore kemi dëshmi të vlerësimit të vazhdueshëm dhe ate nga profesorët Arban Berisha dhe Laura Kusari për lëndet Shfrytëzimi i fuqisë së ujërave II dhe Mbrojtja e integruar nga vershimet.

- Numri i përgjithshëm i lëndëve dimërore: 6
- Numri i lëndëve me dëshmi për vlerësimin e vazhdueshëm: 2
- Përqindja e lëndëve me dëshmi: 33%
- Profesorët që kanë dorëzuar dëshmi:
  - Arban Berisha
  - Laura Kusari
- Lëndët për të cilat është dorëzuar dëshmi:
  - Shfrytëzimi i fuqisë së ujërave II
  - Mbrojtja e integruar nga vershimet

- Ecosystem based management

#### Përmbledhje e Përgjithshme për Departamentin e Hidroteknikës

- Numri total i lëndëve për semestrin dimëror: 35
- Numri i lëndëve me dëshmi për vlerësimin e vazhdueshëm: 20
- Përqindja e përgjithshme e lëndëve me dëshmi: 57%

Shefi i Departamentit të Hidroteknikës,  
Laura Kusari





Për: Prof.Asst.Dr. Florim Grajcevi, Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit  
Nga: Prof.Asst.Dr. Besim Ajvazi, Shef i Departamentit për Gjeodezi, Gjeoinformacion, Observimet e Tokës dhe Hapësirës


Subjekti: Raport për vlerësimin e vazhdueshëm

Datë: 09.01.2025


I nderuar Dekan,

Përmes këtij raporti kemi paraqitur te dhënat mbi lëndët gjegjësisht mësimdhënësit, te cilët kanë paraqitur raportet e vlerësimit të vazhdueshëm. Procesi i vlerësimit të vazhdueshëm nga mësimdhënësit në programet studimore të Gjeodezisë është realizuar në përputhje me vendimin e Senatit 4-431, dt. 11.11.2024.

Në departamentin e Gjeodezisë është treguar gatishmëri e lartë e mësimdhënësve për të shpërndarë rezultatet e tyre në lidhje me procesin e vlerësimit të vazhdueshëm për lëndë përkatëse. Andaj, për programin studimore Gjeodezi, niveli Bachelor, nga gjithsej 18 lëndë që janë brenda semestrave dimërore (I, III, dhe V), kemi pranuar gjithsej raportet e vlerësimit të vazhdueshëm për 18 lëndë, apo 100%. Disa mësimdhënës kanë dërguar raportet e generuara nga platforma elektronike: SEMS, ndërsa disa kanë dërguar raportet personale në excel.



Për programin studimore Gjeodezi, niveli Master, nga gjithsej 12 lëndë që janë brenda semestrave



Ju faleminderit!

Me respekt,

Prof.Asst.Dr. Besim Ajvazi

Nga Raportimet e Departamente konstatohet se në shkallën më të madhe është përmbushur vendimi i Senatit mbi Vlerësimin e vazhdueshëm për Studentët e rregullt për lëndët e semestrit dimëror të vitit akademik 2024/2025,

### 1.1.2 Mësimdhënja Akademike

Organizimi i mësimdhënies përbën shtyllën kryesore të Fakultetit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të programeve të studimeve.

Mekanizmat e mësimdhënies të cilat zbatohen në IAL-në janë bashkëkohore duke numëruar pedagogët e moshës së re të cilët reflektojnë kreativitet gjatë mësimin, përvojës të madhe profesionale të stafit të pedagogëve të institucionit si dhe grada shkencore të cilat sigurojnë rezultate të kënaqshme në zbrëthimin e fenomeneve shkencore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies të cilat zbatohen janë të shumëllojta, ndër të cilat "mësimdhënja një drejtimore" (nga pedagogu te studenti) duke nxitur studentin në pjesëmarrje direkte aktive në mësim. Këto metodologji të mësimdhënies pedagogun e vejnë në rolin primar jo vetëm të profesorit mirëpo edhe të moderatorit.

Në fillim të vitit të ri akademik 2024/2025, 02 tetor 2024, menaxhmenti i FIN-it, në bashkëpunim edhe me ndihmën e Universitetit të Prishtinës, respektivisht me Fakultetin e Edukimit organizoj punëtorinë një ditore me titull "Mësimdhënja e bazuar në Projekte". Kumtues ishte Profesori Nazer Zabeli, kontributi i të cilit ishte i vlerësuar dhe i klasifikuar si i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për mësimdhënësit e FIN.



Gjatë Punëtorisë u shtruan diskutime dhe u shpalosen matjet e bëra lidhur me numrin e studentëve, vlerësimin e vazhdueshëm, vlerësimet e studentëve si dhe qështje tjera aktuale në Fakultet. Nga qëndrimet e punëtorisë, këshilli i FIN në mbledhjen e radhës merr vendim:

**Aprovohen qëndrimet e dalura nga punëtorja e mbajtur “Mësimdhënja e bazuar në Projekte” e organizuar me 02 tetor 2024, me stafin akademik të FIN si në vijim:**

1. Vlerësimi i studentëve ndaj stafit akademik të FIN të jetë i pa ndikuar dhe i pavarur. Stafi akademik i FIN nuk lejohet të ndikoj në vlerësimet e studentëve për lëndët dhe mësimdhënësit.
2. Menaxhmenti i FIN në bashkëpunim me zyrtarin për mësim harton raport të sintetizuar të rezultateve të vlerësimeve të studentëve për lëndët mësimore të cilat realizohen në fund të semestrave dimëror dhe veror.
3. Bazuar në raportet e sintetizuara të vlerësimeve, dhe në rastet e rezultateve të diskutueshme, menaxhmenti i FIN thërret bartësin e lëndës me qëllim të krijimit të mundësisë së plotësimit të lëndës, si dhe plotësimit – përmirësimit të aktiviteteve akademike të tij, dhe kërkohet që reflektimi të jetë i menjëhershëm. *[Statuti i UP-së, nenet 132, 133. 134]*
4. Rezultatet e vlerësimeve të studentëve do të diskutohen në Këshillin e FIN, për periudha kohore – në çdo përfundim të semestrave (dimëror/veror) duke u mbështetur në raporte të sintetizuara të vlerësimeve. Vlerësimet e raporteve mund të bëhet publike me vendim të këshillit të FIN.
5. Bazuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës, me qëllim të rritjes së cilësisë do të realizohet vlerësimi i performances akademike të asistentëve në fund të çdo viti akademik. *[Statuti i UP-së, nenet 132]*. Vlerësimet do të përfshijnë aktivitetet e mësimdhënjes, hulumtimeve shkencore, shërbimet ndaj Institucionit të FIN, si dhe shërbime tjera Institucionale.
6. Vlerësimi i performancës së stafit akademik nga menaxhmenti i FIN, *[Statuti i UP-së, nenet 132, 133. 134]*. Vlerësimet do të përfshijnë aktivitetet e mësimdhënjes, hulumtimeve shkencore, shërbimet ndaj Institucionit të FIN, si dhe shërbime tjera Institucionale.
7. Në të gjitha programet e studimeve, për të gjitha lëndët dhe për të gjithë mësimdhënësit ndalohet zëvendësimi i profesorit nga asistenti duke regjistruar orën e mësimit pa prezencën fizike të mësimdhënësit (regjistrimi i orës së mësimit me ID të bartësit të lëndës nga asistenti). Në rastet e praktikave të tilla, asistentët do të dërgohen në komision diciplinor të etikës.
8. Në nivel të FIN, të përdoret Vlerësimi i Vazhdueshëm për studentët. Vlerësimi i vazhdueshëm është i detyruar për të gjitha programet e studimeve, për të gjitha lëndët mësimore si dhe nga i gjithë stafi akademik i përfshirë në FIN.
9. Bartësit e lëndëve të programeve të studimeve të FIN, mësimdhënësit e përfshirë në procesin mësimor nuk duhet të organizojnë provime ose pjesë të provimeve verbale (me gojë) pa testet me shkrim.
10. Të gjitha departamentet e FIN në mënyrë të rregullt dhe veçanërisht në fund dhe fillim të semestrave të i rishikojnë të gjitha syllabuset e lëndëve me qëllim freskimin e tyre dhe rritjen e efikasitetit të punës me studentët, ndërsa fokusi i veçantë të jetë në:
  - Rezultatet e nxënies.
  - Literatura e obliguar shqip dhe
  - Literatura e rekomanduar.Të gjitha syllabuset do të publikohen në Web FIN si dhe në SEMS.

Në funksion të formës së zgjedhur të mësimdhënies përcaktohet dhe organizimi i mësimdhënies, nëse ai do të jetë ligjëratorë, ushtrime numerike, mësim praktik në terren ose edhe ushtrime laboratorike. Personeli akademik është i lirë të zgjedhë metodikën më të përshtatshme për të zhvilluar dhe organizuar lëndën mësimore. Rëndësi të veçantë ju jepet lëndëve të cilat ushtrojnë vizitat praktike në terrene si dhe ushtrimeve laboratorike duke demonstruar edhe shembuj praktik nga realiteti.

Veçori e Institucionit është monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe mësimdhënësve gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Këtë monitorim e përcjellë vlerësimi i të gjithë mësimdhënësve të angazhuar në programin e studimit të vlerësuar nga studentët. Përmes instrumenteve të vlerësimit të mësimdhënies arrihet cilësia më e lartë e nxënies.

Secila lëndë mësimore ka literaturën e sajë themelore sipas syllabusit dhe literaturën e obliguar dhe të preferuar të cilën Studenti mund ta gjejë ose mësimdhënësi ju siguron paraprakisht.

Kurrikulat e programeve të studimeve si atyre themelore ashtu edhe studimeve master kanë koncept përmbajtësor duke pas për bazë parimet themelore të formimit të programit të studimit nga formimi i grupit të lëndëve të përgjithshme informuese, pastaj grupi i lëndëve teorike shkencore si dhe grupi i lëndëve përmbajtësorë të profesioneve të ngushta nga të cilat dalin edhe kompetencat e veçanta të studentëve pas përfundimit të studimeve.

Gjatë vitit 2024 janë riorganizuar monitorime të procesit të mësimdhënjes, duke vlerësuar në kohë reale përfshirjen e mësimdhënësve përmes dëshmimeve të raporteve të stafit akademik në rexhistruara në platformën SEMS si dhe listat fizike të studentëve në procesin mësimor si dhe prezencën në Fakultet. Raporti i mbajtjes së mësimit, prezencës në Fakultet si dhe raporti i provimeve të mbajtura për studentët shfaqen në mbledhje të rregullta të këshillit të FIN. Raportet krijojnë pasqyrë reale të angazhimeve dhe suksesit, duke vlerësuar cilësinë e mësimdhënjes në aspektin kuantitativ si dhe duke vlerësuar kalueshmërinë e studentëve në aspektin cilësor. Nga këto raporte nxirren konkluzione për hapat e ardhëshëm të veprimit.

Tabela 8: Pasqyra e raportimit të rregullt të mbajtjes së mësimit në FIN për semestrin veror 2023/2024, mësimdhënësit e rregullt FI.

MËSIMDHËNËSIT DHE ASISTENTET ME KONTRATË PUNE F1															
Ky projekt propozim për hulumtime shkencore krijon mundësinë e përfshirjes së stafit akademik të Fakultetit në numër më të gjerë pjesëmarrësish për realizimin e fushave specifike të propozuara. Fusha e projektit (sipas programit kombëtar të shkencës) janë resurset natyrore, energjia, mjedisi dhe ndryshimet klimatike. Këto studime janë të nevojshme dhe të dobishme për banorët e komunes së Pejës dhe interes i përgjithshëm shtetëror duke analizuar dhe vlerësuar rrezikun signifikant nga vërshimet.

Në aspektin akademik, ky projekt hulumtues do të shërbejë si mundësi e krijimit të publikimeve shkencore për stafin, publikime të fushave respektive multidisciplinare, si dhe merrtjes së kapaciteteve hulumtuese në kuadër të Fakultetit.

Ky projekt mundëson pjesëmarrje të stafit, studenteve të Fakultetit në konferenca ndërkombëtare duke shpjeguar, analizuar efekte direkte të vlerësuara dhe të matura.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit e mbështet iniciativën e stafit akademik dhe e përkrahë punën e grupit për projektin e propozuar. Ne rekomandojmë që ky projekt të miratohet duke u klasifikuar si i rëndësishëm së veçantë për fushat me aktualitet ndërkombëtar duke u vlerësuar pozitivisht si projekt hulumtues shkencor.

### 1.3 Instituti i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (IFIN)

Viti 2024 shënon një moment historik për Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe komunitetin akademik: themelimin dhe funksionalizimin e Institutit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Ky institucion është rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme për të avancuar shkencën, teknologjinë dhe inovacionin në fushën e ndërtimit.

Si rezultat i zhvillimeve të shpejta, ngritjes së performancës së komponentës së hulumtimeve shkencore, nevojave dhe kërkesave Institucionale të vendit tonë dhe tregut të punës është domosdoshmëri funksionimi i Institutit të FIN.

Lidhur me themelimin dhe funksionalizimin e institutit të FIN, janë marrë vendime në nivel të këshillit të Fakultetit për drejtorin dhe sekretarin e Institutit, si dhe formimin e këshillit të institutit sipas rregullores të miratuar nga këshilli Drejtues i UP-së. <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,160>, <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,161>, <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,162>.

#### 1.2.1 *Erasmus* +, *CEPUS* projektet ndërkombëtare

FIN ka fituar programin CEPUS, për mobilitetin e studentëve dhe stafin Akademik në bashkëpunim me shumë institucione tjera Evropiane.

Gjatë muajit tetor 2024 për mobilitet të studentëve nga jashtë është nominuar një student i nivelit Master nga Universiteti i BOKU. Ndërsa dy nga stafi mësimdhënës i rregullt, asistentë të FIN kan filluar studimet e doktoratës në universitetin BOKU.

Një asistent nga Departamenti Konstruktiv i FIN është pranuar në studime të Doktoratës në Universitetin Minjo të Portugalisë, një nga Departamenti i Gjeodezisë, Gjeoinformacionit, vëzhgimeve të tokës dhe hapësirës në Universitetin teknik të Çekisë.

#### 1.2.2 **Aktivitet akademik**

Një ngjarje e shënuar nga FIN me 13 mars 2024 duke organizuar “Ditën Përkujtimore të personalitetit të shquar poliedrik shqiptar Prof. Inxh. Gjovalin Gjadri”.

Tubimi është organizuar në mjediset e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN), Universiteti i Prishtinës, në shenjë të 50-vjetorit të ndarjes së Gjovalin Gjadrin nga jeta. Audienca ishte e përbërë me pedagogë, inxhinierë, shkrimtarë, studentë dhe të tjerë të interesuar, nga Kosova dhe Shqipëria, për njohjen e figurës së Prof Gj. Gjadrin.

Tubimi kishte dy sesione: sesioni i parë ju kushtua kryesisht veprës shkencore-inxhinierike të Prof Gj. Gjadrin, kurse i dyti, ju kushtua kryesisht veprës letrare dhe patriotike të tij. Në sesionin e dytë u promovua vepra letrare (drame) e Gj.Gjadri, si dhe prezantimin e disa materialeve nga arkiva e familjes Gjadrin, mbi jetën dhe punën e tij ndër vite.





Foto 2. "Ditët përkujtimore të personalitetit të shquar Gjovalin Gjadri"

Në ngjarjen e organizuar u prezantuan kumtesat sipas Programit vijues.

### **Sesioni i parë**

- 1.- "Prof Gjovalin Gjadri – personalitet i shquar i Shkencës së konstruksioneve dhe projektimit dhe ndërtimit të urave në Shqipëri", nga Prof Niko Pojani.
- 2.- "Vepra "Shkenca e konstruksioneve (vol I)" e Prof Gjovalin Gjadrut dhe aktiviteti i tij – shëmbull i shkëlqyer i një formimi solid shkencor-inxhinierik", nga Prof Asoc Misin Misini
- 3.- "Ura mbi lumin Mat (Monument Kulture) dhe veçori të ndërhyrjeve riaftësuese në periudha të ndryshme kohore", nga Dr Markel Baballëku
- 4.- "Kontribute shkencore-inxhinierike të Prof Egon Gjadrut, si pasues i veprës së Prof Gj Gjadrut", nga Inxh Gëzim Struga, Inxh Foto Dhima dhe Dr Ruben Alite
- 5.- "Pasuria shkencore-inxhinierike që ka lënë Prof Gj. Gjadri dhe promovimi i traditës tonë më të mirë inxhinierike si kërkesë e kohës" (Komunikim online nga Kanadaja me Dr Bujar Morava - Applied Structural Dynamics, Principal, Motioneering Inc., Canada)

### **Sesioni i dytë**

- 1.- "“B2” drama e panjohun gjermanisht e Gjovalin Gjadrut", nga Akademik Prof Ardian Ndreca
- 2.- "Pesha e gjuhës dhe kulturës gjermane në krijimtarinë e Gjovalin Gjadrut", nga Prof Asoc Albulena Blakaj
- 3.- "Gjovalin Gjadri dhe e përkohshmja "Dialeria" e Vjenës" nga Prof Jovan Basho
- 4.- " "Letra grues seme të vdekun" një monument letrar për dashurinë e dhimbjen", nga Ndue Ukaj, shkrimtar

## **1.2.3 Pjesëmarrja në Konferenca**

### **1.2.3.1 Konferencën e 4-të Ndërkombëtare të Inxhinierisë Ekologjike dhe Mjedisore "4 th International Scientific Conference on Ecological and Environmental Engineering" ISCEE**

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" mori pjesë në Konferencën e 4-të Ndërkombëtare të Inxhinierisë Ekologjike dhe Mjedisore, e mbajtur në Beja të Portugalisë, nga data 14 deri më 17 maj 2024.

Udhëhequr nga Dekani dhe i shoqëruar nga shefat e departamenteve Prof. Dr. Laura Kusari dhe Prof. Ass. Dr. Lavdim Osmanaj, dhe anëtarët e stafit akademik Ass. Premton Thaqi dhe Ass. Vlerë Krasniqi, delegacioni ynë u angazhua aktivisht në këtë konferencë të studiuesve, stafit akademik nga IAL-te dhe ekspertëve të industrisë nga e gjithë bota.

Gjatë konferencës, ekipi ynë prezantoi katër punime kërkimore, duke kontribuar në diskutime mbi një gamë të gjerë temash mjedisore, duke përfshirë teknologjinë e ujit dhe ujërave të zeza, vlerësimin e rrezikut mjedisor, zhvillimin e qëndrueshëm, energjinë e rinovueshme dhe më shumë. Këto prezantime lehtësuan shkëmbimin e vlefshëm të ideve dhe njohurive, duke nxitur bashkëpunimin dhe ndarjen e njohurive mes kolegëve.



*Foto 3. Anëtarët e komitetit Organizativ të Konferencës ISCCE*

Ideja e organizimit të kësaj konference ciklike lindi mbi bashkëpunimin e vendosur midis tetë Universiteteve polake: Universiteti i Shkencës së Jetës në Lublin, Universiteti i Bujqësisë në Kraków, Universiteti i Wrocław për Shkencën e Mjedisit dhe Jetës, Universiteti i Shkencës së Jetës në Poznań, Universiteti i Jetës i Varshavës Shkenca, Universiteti i Warmias dhe Mazury në Olsztyn, Universiteti i Teknologjisë në Gdańsk dhe Universiteti i Teknologjisë Rzeszów me Institutin Politeknik të Beja (Portugali). Së fundi institucionet e mëposhtme i janë bashkuar bashkëpunimit në organizimin e konferencës: Universiteti Politeknik i Katalonjës (Spanjë), Universiteti Çek i Shkencave të Jetës në Pragë (Çekia), Universiteti Bujqësor Henan (Kinë), Universiteti i Prishtinës (Kosovë), Universiteti Teknik i Kretës (Greqi), Universiteti i Teknologjisë Lublin (Poloni), Universiteti i Teknologjisë i Varshavës (Poloni) si dhe tre institute Politeknike në Portugali (Coimbra, Setúbal, Viana do Castelo).

Ekipi i FIN pati mundësinë të nxiste dhe të krijonte shumë linja komunikimi dhe bashkëpunimi, me shumë mundësi interesante dhe të vlefshme në të ardhmen e afërt. Një falenderim i veçantë i adresohet Dekanes Klaudia Borowiak dhe gjithë ekipit në Universitetin e Shkencave të Jetës në Poznan, për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre të pafund. Gjithashtu, mirënjohje iu drejtua organizatorëve, veçanërisht Prof. Jorge Tavares dhe drejtuesve tanë të konferencës, Prof. Maria Adelaide Araujo Almeida nga IPBeja dhe Prof. Krzysztof Józwiakowski nga Universiteti i Shkencave të Jetës në Lublin, kolegë delegatë dhe qytetit të Bejës për mikpritjen e tyre të ngrohtë dhe kontributin e tyre të paçmuar në këtë ngjarje të paharrueshme. Së bashku, ne ecim përpara me frymëzim të rinovuar dhe një vizion të përbashkët për një të ardhme më të qëndrueshme.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit pret me padurim mirëpresë të gjithë pjesëmarrësit dhe bashkëorganizatorët nga të gjitha Universitetet e tjera në Prishtinë në vitin 2028.

### 1.2.3.2 Konferenca Ndërkombëtare ISEC2024 (Structural Engineering and Construction Conference)

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetin e Prishtinës nga 13 deri 18 maj 2024 mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare ISEC2024 (*Structural Engineering and Construction Conference*) e mbajtur në Vilnius të Lituaniës.

Delegacioni i stafit akademik të Fakultetit në përbërje nga Prof. Dr. Naser Kabashi dhe MSc.Valon Veseli, kontribuan me punim shkencorë si dhe me aktivitete rreth vijimit të konferencës duke moderuar seanca të saja. Stafi akademik gjatë konferencës kishte takime të ndara me shumë pjesëmarrës nga shumë shtete të Evropës dhe të Shteteve të bashkuara të Amerikës me qëllim rritjen e bashkëpunimeve institucionale, organizimin e konferencave të përbashkëta në të ardhmen si dhe bashkëpunimet direkte me individ.



Foto 4. Pjesëmarrja e stafit akademik të FIN në ISEC 2024

Punimi shkencor i stafit akademik ne titull “*Optimizing fine aggregate and cement replacement with Stone Dust: Impact on Concrete Compressive Strength*”, i prezantuar nga Prof.N.Kabashi ishte mbresëlënëse për audiencën. Gjatë zhvillimit të konferencës pjesëmarrësit kontribuan në diskutime lidhur me temat me interes për fushat e teknologjisë së materialeve, inxhinierinë sizmike, menaxhimi i ndërtimit etj.

Pjesëmarrja e stafit mësimdhënës të FIN, UP në konferencën e 10-të Ndërkombëtare për Strukturat e Çelikut dhe Aluminit “10<sup>th</sup> ICSAS 2024 - *International Conference on Steel and Aluminium Structures*” e cila u zhvillua në Rio de Janeiro, Brazil, nga data 5 deri më 7 qershor 2024, me punimin “*Experimental and Numerical Analysis of Extended End-Plate Connection with Two and Four Bolts*”, të autores MSc Anita Gjukaj.



Foto 5. Presantimi i punimit në ICAS 2024, Rio de Janeiro, Brasil

Me 7 nëntor 2024, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit mirëpret Komisionin Këshilldhënës Zviceran për Bashkëpunim Ndërkombëtar: Një Hap Kyç për të ardhmen e Menaxhimit të Resurseve Ujore në Kosovë.

Delegacioni u mirëprit nga Rektori i Universitetit të Prishtinës, Prof. Dr. Arben Hajrullahu, dhe Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Prof. Ass. Florim Grajçevci, si dhe përfaqësues të komunitetit akademik, studentë dhe partnerë të tjerë. Me mbështetjen e **Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim** në Kosovë në kuadër të Programit **IWRM-K**, kjo ngjarje nënvizoi përparimin e përbashkët në avancimin e ekspertizës në këtë fushë dhe forcimin e partneritetit mes Kosovës dhe Zvicrës në menaxhimin e resurseve ujore.

Siç theksoi Rektori Hajrullahu, “Ky program po na ndihmon të formojmë një gjeneratë të re profesionistësh të ujit—një investim i rëndësishëm me kthimet më të mira për të ardhmen e Kosovës.” Delegacioni nga Komisioni Këshilldhënës pati mundësinë të përjetojë nga afër ndikimin e programit të studimeve M.Sc. në #IWRM, avancimet në menaxhimin e resurseve ujore, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe përpjekjet për promovimin e praktikave të qëndrueshme në sektorë të ndryshëm. Delegacioni gjithashtu pa investimet e financuara nga Programi IWRM-K në infrastrukturën akademike të universitetit, përfshirë pajisjet më të fundit teknologjike dhe laboratorin modern të ujit, që kontribuojnë në edukimin e profesionistëve të ardhshëm.

Ngjarja theksoi gjithashtu objektivat ambicioze për Fazën 2, e cila premtonte mbështetje edhe më të madhe transformuese për Universitetin e Prishtinës dhe resurset ujore të Kosovës.



Foto 6. Seanca e takimeve Institucionale UP, FIN dhe Delegacioni nga Parlamenti Zviceran

#### 1.2.4 Stafit akademik i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

Stafit Akademik i rregullt, është aktiv në avancime me grada shkencore dhe tituj akademik. Njësia jonë akademike hulumton edhe tregun e punës për krijimin e mundësive të reja me kuadro profesionale dhe aktualisht mendohet edhe për krijimin e programeve të reja të studimeve.

Duke pas parasysh lëvizjet e stafit akademik, avancimet, pensionimet, mundësitë e projekteve të reja për programe të studimeve Fakulteti është i detyruar të riorganizohet në vazhdimësi në mënyrë që të arrihet cilësia sa më e lartë e studimeve dhe njëkohësisht të mendohet edhe në projektet e ardhshme.

Nga janari deri në gusht të vitit 2024, numri i stafit akademik me kontratë të rregullt 37, nga të cilët 22 janë mësimsdhënës ndërsa 15 janë asistent. Në muajin gusht 2024 është pensionuar një mësimsdhënës me gradën Prof.ass.Dr.




Figura 11. Stafit akademik i rregullt i FIN - 2024

Numri i përgjithshëm i stafit të rregullt të FIN-it në vitin 2024, për vitin akademik 2024/2025 është 36.

Stafit akademik i angazhuar në FIN për vitin akademik 2024/2025 sipas thirrjes së publikuar dhe zhvillimi i procedurave deri në përfundim nga këshilli i FIN janë sipas këtyre statistikave:

Tabela 15, Stafit akademik i angazhuar sipas konkursit në FIN për vitin akademik 2024/2025.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike
1.	Ardian Kadiri	Asistent bashkëpunëtor
2.	Armend Mujaj	Asistent bashkëpunëtor
3.	Festina Sadiku	Asistent bashkëpunëtor
4.	Altin Mujaj	Asistent bashkëpunëtor
5.	Liron Morina	Asistent bashkëpunëtor
6.	Lulzim Hajdini	Asistent bashkëpunëtor
7.	Valon Azizi	Asistent bashkëpunëtor – është dorheqë në fund të dhjetorit 2024
8.	Ylli Murati	Asistent bashkëpunëtor
9.	Drilon Begaj	Asistent bashkëpunëtor
10.	Ardita Ibishi	Lektore

11.	Ilir Rodiqi	Mësimdhënës
12.	Islam Fejza	Mësimdhënës
13.	Ismajl Kabashi	Mësimdhënës

Tabela 16, Stafit akademik i pensionuar i angazhuar në FIN për vitin akademik 2024/2025.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike
1.	Fevzi Berisha	Mësimdhënës
2.	Abdullah Zejnullahu	Mësimdhënës
3.	Misin Misini	Mësimdhënës
4.	Ragip Hadri	Mësimdhënës

Tabela 17, Stafit akademik i angazhuar nga njësitë tjera të Universitetit të Prishtinës në FIN për vitin akademik 2024/2025.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike	Njësia Akademike e UP-së
1.	Arta Basha Jakupi	Mësimdhënës	FA
2.	Violeta Nushi	Mësimdhënës	FA
3.	Mimoza Dugolli	Mësimdhënës	FA
4.	Dukagjin Hasimja	Mësimdhënës	FA
5.	Dashnor Kadiri	Asistent	FA
6.	Rrona Berisha	Asistent	FA
7.	Kaltrina Spahiu	Asistent	FA
8.	Mjellma Carrabregu	Mësimdhënës	FF
9.	Linda Gusia	Mësimdhënës	FF
10.	Arben Mehmeti	Mësimdhënës	FBV
11.	Visar Morina	Mësimdhënës	FE
12.	Halil Ibrahimimi	Mësimdhënës	FBV
13.	Arlinda Bresa	Asistent	FIM
14.	Ferdije zhushi Etemi	Mësimdhënës	FSHMN
15.	Rexhep Selimaj	Mësimdhënës	FIM
16.	Jeton Halili	Mësimdhënës	FSHMN
17.	Halil Ibrahimimi	Mësimdhënës	FSHMN
18.	Idriz Vehapi	Mësimdhënës	FSHMN
19.	Naim Jerliu	Mësimdhënës	FM
20.	Gazmend Nafezi	Mësimdhënës	FSHMN

Tabela 18, Stafit akademik Profesor Vizitor të angazhuar në FIN për vitin akademik 2024/2025.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike	IAL-ja
1.	Neritan Shkodrani	Mësimdhënës	FIN - UPT, Shqipëri
2.	Oltion Marko	Mësimdhënës	FIN – UPT, Shqipëri
3.	Lars Ribe	Mësimdhënës	FA – Koln, Gjermani
4.	Sudeh Dejnavi	Mësimdhënës	FA – Koln, Gjermani
5.	Xhesika Hoxha	Hulumtuese shkencore	FA – Koln, Gjermani
6.	Luis Ramirez	Mësimdhënës	FA – Koln, Gjermani
7.	Rosa Allabati	Mësimdhënës	Univ. BOKU Vjene
8.	Biljana Puleska	Mësimdhënës	K&M, Shkup, RMV
9.	Vlado Spiridonov	Mësimdhënës	K&M, Shkup, RMV
10.	Cvetanka Popovska	Mësimdhënës	K&M, Shkup, RMV

Gjithsej numri i përgjithshëm i stafit akademik të përfshirë në procesin mësimor në FIN për vitin akademik 2024/2025 është 83. Si rezultat krahasimi për raportin e numrit të studentëve për një mësimdhënës është  $960/80 = 12$  student për mësimdhënës.




Figura 12. Stafi akademik i angazhuar i jashtëm dhe vizitor për 2024/2025

Stafi akademik i angazhuar me kontratë (F3), sipas konkursit, për vitin akademik 2024/2025 janë 13 mësimdhënës, njëri nga të cilët në formë zyrtare jep dorëheqje në dhjetor të vitit 2024.

### 1.2.5 Stafi akademik i përfshirë në mësimdhënje i financuar nga burimet publike dhe private.

Programi i studimeve Master për menaxhimin e resurseve ujore është i mbështetur financiarisht nga zyra Zvicrane në Kosovë përmes zyrës së SKAT-it, që nga vitit 2023.

Programi i studimit është akredituar në vitin 2023 dhe fillon vitin e parë në 2023/2024 dhe vazhdon në 2024/2025. Programi MSc për MIRU organizohet në gjuhë Anglishte dhe pranon student ndërkombëtar.

Sikur në vitin e parë të zhvillimit të programit ashtu edhe në vitin e dytë SKAT-i ka realizuar kontratë me stafin akademik të Universitetit Koln si dhe me Universitetin K&M në Shkup. Stafi që financohen nga SKAT, janë sikur në tabelën 19

Tabela 19, Stafi akademik i financuar nga SKAT në FIN për vitin akademik 2024/2025.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike	IAL-ja
1.	Lars Ribe	Mësimdhënës	FA – Koln, Gjermani
2.	Sudeh Dejnavi	Mësimdhënës	FA – Koln, Gjermani
3.	Xhesika Hoxha	Hulumtuese shkencore	FA – Koln, Gjermani
4.	Luis Ramirez	Mësimdhënës	FA – Koln, Gjermani
5.	Rosa Allabati	Mësimdhënës	Univ. BOKU Vjene
6.	Biljana Puleska	Mësimdhënës	K&M, Shkup, RMV
7.	Vlado Spiridonov	Mësimdhënës	K&M, Shkup, RMV
8.	Cvetanka Popovska	Mësimdhënës	K&M, Shkup, RMV

Universiteti i Prishtinës (UP)/Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit/Departamenti i Hidroteknikës ka realizuar bashkëpunim strategjik me Technische Hochschule Köln (TH Köln), i mundësuar nga Programi për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM-K).

Ky partneritet përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në avancimin e arsimit dhe kërkimeve në menaxhimin e integruar të resurseve ujore (IWRM) në UPHP. Përmes këtij bashkëpunimi, synojmë:

- **Përmirësimin e Programit MSc-IWRM:** Duke ofruar leksione të avancuara, trajnime dhe mbështetje praktike në hulumtime për studentët tanë.
- **Riakreditimin e Programit MSc-IWRM:** Me përditësime të përshtatura për kërkesat e tregut dhe sfidat e reja mjedisore.
- **Avancimin e Kërkimeve për Resurset Ujore:** Duke shfrytëzuar ekspertizën për të udhëhequr studime me ndikim dhe bashkautorësi të botimeve akademike.
- **Promovimin e Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë (NbS):** Përmes trajnimeve të synuara dhe projekteve pilot inovative që adresojnë sfidat lokale mjedisore.

Ky partneritet thekson përkushtimin e UP-së për të ofruar arsim të avancuar dhe për të nxitur zgjidhje që adresojnë sfidat e menaxhimit të resurseve ujore të sotme.



## 1.4 AKTIVITETET TJERA SHËRBYESE, KËSHILLDHËNËSE DHE PROJEKTET E REALIZUARA

### 1.4.1 Aktivitetet e stafit akademik të FIN të përfshirë në punëtori të ndyshme.

- Punëtorja “Sfida dhe Inovacione për diga më të mira”, e organizuar në Tiranë, Aktivitet i organizuar në bashkëpunim me Komitetin Francez të Digave dhe Rezervuarëve (CFBR), duke u përfaqësuar nga stafi akademik i FIN, MSc Hana Shehu.



Foto 7. Punëtorja e organizuar nga ASHAK – Tiranë.

### 1.4.2 Fushatë për studentët e rinj.

- 11 Korrik 2024, 09:00-12:00 në FIN. Për herë të parë, ne hapim dyert e fakultetit tonë për të mirëpritur në ngjarjen Open House! Ky event ishte një mundësi e shkëlqyer për të informuar kandidatët potencialë dhe të gjithë të interesuarit rreth ofertave unike të universitetit tonë. Maturantet paten mundësinë të:
  - Mësonin rreth programeve akademike dhe mundësive të tjera që ofrojmë.
  - Bashkëbisedonin me profesorët dhe studentët aktualë të fakultetit.
  - Vizitonin objektet, laboratorët, bibliotekat dhe hapësirat e tjera të veçanta



Foto 8. Momente nga shënimi i ngjarjes “Open House” në ambiente të FIN.

#### 1.4.3 Ligjëratat e hapura të organizuara nga FIN

FIN ka një traditë të organizimit të ligjëratave të Hapura nga Kuntues dhe shkencëtar nga rajoni dhe bota. Gajtë këtij viti u organizuan kët ligjërata:

- Ligjërata e hapur 27 qershor 2024, Prof. Dr.-Ing. Klaus Holschemacher HTWK Leipzig University of Applied Sciences, Structural Concrete Institute, Head of Institute “**Timber Concrete Composite**”



Fotografi 9. Audiencia e perbere nga stafi akademik dhe Studentët e FIN në ligjëratën e hapur.

- Ligjëratë e Hapur 21 nëntor 2024, **Dr. Jason Harris, PhD "Radiation, Radiation Protection, and its Application to Civil and Environmental Engineering"** Profesor në “Radiological Health Sciences in the School of Health Sciences” dhe drejtor në “Center for Radiological and Nuclear Security (CRANS)” në Purdue University in West Lafayette, Indiana USA.

Fakulteti i Ndërtimtarisë – Faculty of Civil Engineering

**PURDUE UNIVERSITY**

**Ligjëratë e hapur - Open Lecture**

**Fulbright Specialist**

**21 Nëntor – November 21, - 2024 (A – 415, 12:00 – 13:00)**

**Radioaktiviteti, Mbrojtja Radioaktive dhe përdorimi në Inxhinierinë e Ambientëve**  
-  
**Radiation, Radiation Protection, and its Application to Civil Environmental Engineering**

Professor Harris Jason  
School of Health Sciences and Director of the Center for Radiological and Nuclear Security  
Purdue University in West Lafayette, Indiana USA

Figura 13. Njoftimi për ligjëratën e hapur “Radioaktiviteti, mbrojtja radioaktive dhe përdorimi në Inxhinierinë e Ambientit”

#### 1.4.4 Marrëveshjet e arritura të FIN

Misioni i FIN është ndërkombëtarzimi dhe kjo komponentë e aktiviteteve Institucionale nuk ka mungu gjatë vitit 2024. Janë këto marrëveshje Institucionale të realizuara:

- Marrëveshja me Universitë degli Studi dell’Insubria DEPARTMENT OF THEORETICAL AND APPLIED SCIENCES – diSTA, dhe Universiteti i Prishtinës ne prill 2024
- Marrëveshja me Sharrcem dhe Fakulteteve FIN, FA, FIEK dhe FIM, ne shtator 2024
- Marrëveshja me USAID për Partneritet të Ri! 31 korrik 2024. Memorandum Mirëkuptimi (MoU) për një Iniciativë Inovative për Ruajtjen e Ujit. Ky partneritet bashkon Aktivitetin Adaptues të USAID Kosova, Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të UP-së dhe NPL „Gjelbër“ sh.a.
- Marrëveshje bashkëpunimi ne mes te FIN dhe Digitex System, Shkup 09 korrik 2024.
- Marrëveshje bashkëpunimi ne mes te FIN she SHSKUK lidhë me realizimin e projektit shkencor hulumtues “Vlerësimi i Stabilitetit dhe sanimi i objekteve brenda QKUK” qershor 2024
- Marrëveshja ne mes te IFIN dhe INNOTECH Project, shkup, maj 2024.

#### 1.4.5 Programet e Studimeve të FIN, aktivitetet rreth riakreditimeve të programeve BSc dhe MSc.

Në nivel të Fakultetit programet e studimeve të akredituara sipas vendimeve nga KSHC-ja respektivisht Agjencioni i Kosovës për Akreditim (AKA) janë:

Sipas vendimit të AKA-së nr. 3020/21 të datës 12 gusht 2021, të gjitha programet e studimeve të FIN-së riakreditohen sipas kësaj radhitje dhe kohe:

- Programi i studimeve BSc Gjeodezi – 5 vite (21/22 deri në 25/26)
- Programi i studimeve BSc Konstruktiv – 3 vite (21/22 deri në 23/24)
- Programi i studimeve MSc Konstruktiv – 3 vite (21/22 deri në 23/24)
- Programi i studimeve BSc Hidroteknikë – 3 vite (21/22 deri në 23/24)
- Programi i studimeve MSc Hidroteknikë – 3 vite (21/22 deri në 23/24)

Sipas vendimit të AAK-së nr. 941/22 të datës 18 korrik 2022, riakreditohen programet e studimeve për periudhën pesë vjeçare, sipas;

- Inxhinieria e Ambientit, BSc, 180 ECTS, 5 vite (22/23 deri 26/27)
- Gjeodezi, MSc, 120 ECTS, 5 vite (22/23 deri 26/27)

Sipas vendimit të AKA-së nr. 1003/23 të datës 26 korrik 2023, akreditohet programi i studimeve

- MSc Menaxhimi i Integruar i resurseve Ujore, 120 ECTS, në periudhën prej tri viteve (23/23 deri 25/26).

Viti 2024 karakterizohet me aktivitete të riakreditimit të tri programeve të studimeve. Për riakreditim janë përgaditur dosjet e BSc Hidroteknikë, BSc Konstruktiv dhe MSC Konstruktiv.

Dosjet e programeve të studimeve së bashku me RVV-të e tyre janë angazhuar stafi akademi, administrata si dhe studentët përmes grupeve punuese duke i përfshi edhe bartësit e programeve.

Si rezultat i vizitës së eksperteve të jashtëm në FIN me 18 qershor 2024 është vonuar edhe vendimi i riakreditimit të programeve të studimeve.

Sipas vendimit të AKA-së nr: 1628/24 të datës 20 gusht 2024 riakreditohen programet e studimeve:

- MSc Konstruktiv 2024 deri 2027
- BSc Konstruktiv 2024 deri 2029
- BSc Hidroteknike 2024 deri 2027

E pa akredituar, MSc Hidroteknike, arsyet e mospërbushjes së standardeve të bartësve të programit të studimit. FIN ka aplikuar për riakreditim për vitin 2025, derisa për bartës të programit MSc Hidroteknikë është nominuar një mësimdhënës nga FSHMN, Departamenti i Kimisë. Edhe përkundër anikimimeve në adresë të KSHC-së, prap programi i studimeve MSc Hidroteknikë është refuzuar me arsyetim të bartësit të programit.




Figura 14. Programet e studimeve të FIN-së të riakredituara nga viti 2021-2022

Kriteret – standardet e reja të Agjencionit të Kosovës për Akreditimit, përkatësisht Këshillit Shtetërorë të Cilësisë për akreditimin dhe riakreditimin e programeve të studimeve do të jenë sfiduese për programet e organizuara nga FIN për periudhën e ardhshme të akreditimeve përkatësisht riakreditimeve. Brenda FIN-it organizohen 4 programe BSc dhe 3 programe MSc të studimeve.

Tabela 19 Akreditimet dhe Ri akreditimet e programeve studimore

Programet Studimore	Akreditimi i parë	Ri-akreditimi	Ri-akreditimi III	Ri-akreditimi IV +2 vite vazhdim Covid	Ri-akreditimi V	Ri-akreditimi i VI
<b>BSc</b>						
Konstruktiv (BSc)	2009 - 2012	2012 - 2015	2015 - 2016	2016-2019 (+2vite)	2021-2024	2024-2029
Hidroteknikë (BSc)	2009 - 2012	2012 - 2015	2015 - 2016	2016-2019 (+2vite)	2021-2024	2024-2027
Gjeodezi (BSc)	2009 - 2012	2012 - 2015	2015 - 2016	2016-2019 (+2vite)	2021-2026	
Inxhinieri e Ambientit (BSc)	2015 - 2018	2019-2022	2022-2027			
<b>MSc</b>						
Konstruktiv (MSc)	2009 - 2012	2012 - 2013	2014 - 2017	2017-2020	2021-2024	2024-2027
Hidroteknikë (MSc)	2009 - 2012	2012 - 2013	2014 - 2017	2017-2020	2021-2024	
Gjeodezi (MSc)	2015 - 2018	2019-2022	2022 - 2027			
Infrastruktura Rrugore (MSc)	2011 - 2011	2012 - 2013	2014-2017			
MIRU - IWRM	2023-2026					

## 1.5. Aspekte financiare të FIN në vitin 2024

Tabela e zërave buxhetor të shpenzuara në vitin 2024

Zëri buxhetor	Shuma	Përshkrimi
Organizimi i konferencës shkencore ISCE2023	16,500.00 €	Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit dhe shpenzime tjera të konferencës së përbashkët shkencore në mes të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Fakultetit të Ndërtimtarisë, Universiteti i Prishtinës, e planifikuar në maj 2023 në Tiranë.
Mjete të konkretizimit	4,585.48 €	2 Smart Board për pajisjen e klasave të mësimt.
	3,656.00 €	Futja ne funksione e sallës se kompjuterëve per Gjeodezi. Instalime te rrjeteve, pajisjeve te lidhjes se kompjuterëve.. etj deri ne funksionim te plote.
	27,540.00 €	20 Kompjuter per laboratorin e IT-se per programet e studimeve ne Konstruktiv.
Pajisje laboratorike	150,000.00 €	Pajisje për laboratorët e konstruksioneve, materialeve, asfaltit, gjeomekanikës, hidroteknikës, gjeodezisë dhe inxhinierisë së ambientit. Një pjesë e pajisjeve të laboratorit të konstruksioneve, e kontraktuar në vitin 2022 në vlerë prej 150.000,00€ si dhe 25.000,00€ nga buxheti i vitit 2023.
Servisimi – kalibrimi i pajisjeve ekzistuese.		Servisimi – kalibrimi i pajisjeve ekzistuese.
Renovimi i kulmit	191,409.10 €	Renovimi komplet i katit te 5-te, Plafonet, dyshemete, ndriqimi, instalimet CCTV, Interneti, dyshemet, muret, hapje të ndriqimeve në korridore, Riorganizimi i hapësirave ne korridor, rritja e salles se kompjuterëve per studentet te programeve te studimeve ne Konstruktiv - Laboratori i kompjuterëve, enterieri per kompjuteret, arredimi i korridoreve etj...

## 1.5. Marrëveshjet e arritura të FIN me subjektet tjera në vitin 2024

Janë disa marrëveshje të bashkëpunimit të arritura të Fakultetit me Institucionet tjera me qëllim të bashkëpunimit, shërbimeve të ndryshme si dhe realizimit të praktikave për studentët.

- Memoarndumi i mirëkuptimit për bashkëpunim institucional në mes të FIN dhe KRU, Gjakova, e nënshkruar me 24.10.2024 nr.prot. 21391/1. Ky MMB ndërinstytucional përveq tjerash i referohet kryesisht realizimit të praktikave të studntëve në KRU Gjakova.
- Memorandum bashkëpunimi në mes te Agjensisë Kadastrale të Kosovës dhe FIN me nr prot. 165/1 të datës 23 Janar 2024 që i referohet bashkëpunimit ndërinstytucional për qështje të Kadastrit dhe Gjeodezisë për nevojat e Studentëve si dhe shërbimeve tjera të cilat ishin të konsiderueshme të mëdha gjat vitit 2024 për kampuset Universitare të UP-së.
- Memorandum Bashkëpunimi në mes të Titan Sharrcem dhe Fakultetit të Inxhiniersisë Ndërtimit, Fakultetit të Arkitekturës, Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike me nr prot: 1827/1 të datës 24.09.2024. MB ju shërben palëve të Institucionave për zhvillime të praktikave të studentëve, organizimin e ngjarjeve akademike si dhe zhvillimi e hulumtimeve të lidhura me tregun e punës.
- Aneks Memorandum i Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Kulturës, rinisë dhe Sportit dhe Fakultetit të Inxhiniersisë së Ndërtimit, Fakultetit të Arkitekturës, Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike me nr prot: 2737/1 të datës 17.12.2024 që i referohet kompetencave të kaluara nga MKR tek njësitë akademike përcjelljen e punimeve ndërtimore në Teatrin Kombëar të Kosovës në Prishtinë. Ky aneks i MB është vazhdimësi e Marrëveshjes së realizuar në vitin 2023 lidhur me TKK.
- Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Universitetit të Prishtiës dhe Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit ARRU me nr. protk: 1596/1 të datës 30.08.2024. Kjo marrëveshje i referohet Fakultetit të Inxhiniersisë së Ndërtimit lidhur me aktivitete ndërinstytucionale për qështjen e Ujit, studentëve të Hidroteknikës, Programeve të studimeve etj.
- Marrëveshja në mes të IWRM Kosovo Program dhe Universitetit të Prishtinës me nr prot: 1296/1 të datës 20.06.2024. Marrëveshja i referohet vazhdimit të bashkëpunimit të UP-së respektivisht FIN me SKAT dhe programin IWRM për periudhën 2024 deri 2029.
- Marrëveshja e mirëkuptimit në mes të DiGitex dhe Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit me nr prot: 1401/1 të datës 09.07.2024. Kjo marrëveshje i referohet realizimit të matjeve ambientale të objekteve muraturë në zonën e Ulpianës në Prishtinë si pjesë e projektit Hulumtues “Vlerësmi dhe sanimi i objekteve ekzistuese muraturë në zonën e Ulpianës” – 2024.

- Marreveshja e Përgjithesuar për Bashkëpunim në zhvillim e Teknologjive Inovative për mbrojtje sizmike të Strukturave të bazuara në modele eksperimentale me nr prot: 11561/1 të datës 29.05.2024 në mes të RESIN Laboratory of Industrial and Technology, Skopje lidhur me INNOTECH Project dhe FIN,UP.
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet MASHT, Republika e Kosovës dhe Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit,UP nr. prot: 738/1 të datës 03.04.2024, për realizimin e projektit shkencorë “Riparimi i strukturave të muratuara duke përdorur metodat e aplikimit FRP”.
- Aneks Marrëveshje e bashkëpunimit në mes të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, ARRU dhe FIN,UP nr prot: 562/1 të datës 04.03.2024. Marrëveshja i referohet bashkëpunimeve të ndërsjellta Institucionale të fushave të Hidroteknikës dhe ujit.
- Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të SHSKUK-së, QKUK-së dhe Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit me nr prot: 1224/1 të datës 10.06.2024 lidhur me hartimin e projektit hulumtues për “Vlerësimin e aftësisë mbajtëse dhe sanimi i objekteve ekzistuese të SHSKUK, QKUK-së Prishtinë”.
- Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Arkivit Komunal të Prishtinës dhe Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit nr prot: 273/1 të datës 31.01.2024. Lidhur me mundësitë e shfrytëit të dokumentacioneve për nevojat institucionale, projektev hulumtuese, diplomave te Studentëve, etj.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë zhvilluar shumë takime kolegjiale në nivel të njësisë tonë akademike duke marr vendime të rëndësishme për procese të mbarëvajtjes së aktiviteteve akademike.

Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit,  
Prof.ass.Dr. Florim Grajçevci

